



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr. 53.Prot

Korçë më 26/10 / 2023

Njoftim për shpallje të vendit të lirë.

Drejtuar: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 2019 “Për nxitjen e punësimit”, ligjit nr.15. datë 2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” Udhëzimit Nr.14 datë 27.05.2021 Neni 108 pika 7, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë të institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë të zhvillimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”

Njoftojmë për shpallje të vendit të lirë për pozicionet :

Mësimdhënës me kohë të pjeshme 16 ore/javë

- Mësues i teorisë profesionale (Veterinari)

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në shkollën Profesionale Shërbime, Korçë.

1.1.Aplikanti duhet të plotësojë **kriteret e përgjithshme** për lëvizjen paralele si vijon :

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës të prerë për kryerjen e veprave penale .
- Te mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- Të demostrojë vlera të larta të etikës,sjelljes dhe komunikimit.
- Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit .

1.2.Aplikanti duhet të plotësojë **kriteret e posaçme** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në shkollën Profesionale Shërbime, Korçë si vijon :

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga

kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentat e aplikimit

- Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë ;
- Letërmotivimin për pozicionin.
- Jetëshkrimin (CV), sipas modelit Europass Curriculum Vitae
- Kartën e identitetit.
- Diplomën.
- Librezën e punës.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV.
- Çertifikatë apo dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore .
- Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka më masa disiplinore në fuqi.
- Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 06.11.2023.

Drejtoreshë shkollë

Tatiana MERO

